

Ministria e Financave paraqet strukturën e re me 1 mijë punonjës

Struktura e re, ndryshon numri i doganierëve

ADI SHKËMBI

Ministria e Financave ka hartuar strukturën e re të administratës doganore, e cila do të ketë 1 mijë punonjës në degët e saj në të gjithë vendin.

Në mbledhjen e djeshme të Këshillit të Ministrave, ministri Bode ka paraqitur strukturën e re së bashku me organigramën e kësaj drejtorie. Por burime pranë Këshillit të Ministrave bëjnë të ditur se ky projektvendim nuk është miratuar dhe është kthyer për rishqyrtim sërisht në Ministrinë e Financave.

VENDIMI

Sipas projektvendimit të hartuar nga ministri i Financave, administrata doganore do të ketë 1 mijë punonjës. Në drejtorinë qendrore, numrin më të madh do ta ketë Departamenti Operativ Hetimor i cili do ketë 207 punonjës ndërkohë që pas tij janë departamenti administrativ me 82 punonjës dhe departamenti teknik me 70 punonjës. Për sa i përket doganave në 20 pika të vendit, numrin më të madh, kjo edhe për nga vëllimi i punës e ka dogana e qytetit të Durrësit, e cila do të ketë në organikën e saj 104 punonjës. Pas saj është dogana e Tiranës me 63 punonjës dhe dogana e Shkodrës me 54 punonjës. Në relacionin e këtij projektvendimi, ministri i Financave, Ridvan Bode thotë se, "administrata doganore pas vlerësimit me objektivitet të zhvillimeve të kohëve të fundit dhe objektivave të vëna përpara kësaj strukture janë rishikuar të gjitha strukturat përberëse, duke hartuar një projekt strukture të re me funksionale. Qëllimi kryesor i projektvendimit është ndryshimi i strukturës organike dhe organigramës së administratës doganore". Sipas Bodes, janë pakësuar pozicionet drejtuese me synim përforcimin e kontrollit mbi menaxhimin dhe zbatimin e metodave të punës, si dhe

STRUKTURA ORGANIKE E ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE	
Struktura	Nr. i punonjësve
Drejtoria e Përgj. e Doganave	5
Marrëdhëniet me jashtë	3
Kontrolli i Brendshëm	11
Departamenti administrativ	82
Departamenti teknik	70
Departamenti Operativ Hetimor	207
Dogana Shkodër	54
Dogana Lezhë	17
Dogana Bllatë (Peshkopi)	17
Dogana Kukës (Morinë)	38
Dogana Tiranë	63
Dogana Durrës	104
Dogana Rinas	44
Dogana Elbasan	20
Dogana Qafë Thanë	43
Dogana Korçë	22
Dogana Kapshticë	36
Dogana Vlorë	34
Dogana Fier	19
Dogana Berat	10
Dogana Kakavijë (Gjirokastrë)	43
Dogana Sarandë	20
Dogana Tri Urat (Përmet)	15
Rajoni Tiranë	9
Rajoni Shkodër	7
Rajoni Elbasan	7
Totali i punonjësve në dogana	1000

rritjen e efikasitetit të strukturave organizative dhe lehtësimin e sistemit të komunikimit brenda strukturave. Gjithashtu është rritur edhe numri i pozicioneve operative ekzekutive për rritjen e efikasitetit në strukturat operacionale. Kjo strukturë ka pësuar ndryshime edhe për faktin se janë shtuar pikat doganore, ku së fundi janë vënë në punë edhe dogana e Qafë Morinës dhe Qafë Prushit. Sipas Bodes, "organika e re synon modernizimin e strukturave të sistemit doganor me anë të shpërndarjes më të mirë të burimeve ekzistuese jo vetëm në qëllimin e miratimit të burimeve njerëzore, mjeteve dhe tërësimit doganor, por edhe në krijimin

e një sistemi doganor në funksion të lehtësimin të shërbimeve për tregtinë e ligësme përkundrejt tregtisë së efektive të kontrollit doganor në luftë ndaj shkeljeve, evazionit fiskal dhe trafikëve të jashtëligjshme. Përfundimisht, duke marrë në konsideratë sa më lart dhe objektivat gjithnjë në rritje të administratës doganore, propozimi ynë është që organika e administratës doganore të përbëhet nga 1 mijë punonjës.

DAP

Departamenti i Administratës Publike në varësi të Ministrisë së Brendshme, nuk ka qenë dakord fillimisht me mënyrën se si ministria e financave donte ta miratonte këtë vendim. "Në zbatim të

nenit 13, kreu 2, të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet se, me propozim të ministrit të Financave, është Këshilli i Ministrave që përcakton organikën e administratës doganore. Për rrjedhojë, edhe ndryshimet përkatëse duhet të miratohen me akt të së njëjtës hierarki, pra me vendim të Këshillit të Ministrave dhe jo me urdhrë të Kryeministrit, siç është rasti i propozimit të paraqitur", thuhet në letërën e Blerita Selenicës, drejtore e DAP. Kjo ka bërë që Ministria e Financave ta kthejë mbrapsht strukturën, duke e paraqitur në mbledhjen e djeshme në formën e projektvendimit.



Doris Pack

Pack: Topi më tha se s'e heq dot Sollakun

Presidenti Topi e ka të pamundur që të shkarkojë Sollakun nga posti i kryeprokurorit. Këtë fakt e ka bërë të ditur euro-parlamentarja Doris Pack gjatë emisionit "Studio e Hapur" në TV Alsat. Pack ka bërë të ditur se presidenti kërkon që kjo çështje të zgjidhet nga presidenti. "Folëm me presidentin dhe ai nuk e tha këtë. Ai tha se nuk e heq dot prokurorin e Përgjithshëm. Ai po pret përgjigjen e Parlamentit dhe nëse e mbaj mend mirë, nuk ka asgjë kundër një tryeze të rrumbullakët për të zbuluar ku qëndron problemi. Nëse problemi mund të jetë prokurori mund të ketë një zgjidhje nëse jo, duhet të ndryshoj procedurën. Nuk na e tha këtë", deklaroi Pack. Ajo më pas theksoi se këtë çështje duhet ta zgjidhë klasa politike shqiptare, pa ndërhyrjen e ndërkombëtarëve. "Lini ta zgjidhë politika shqiptare. Mos na kërkoni ne të ndërhyjmë; ne nuk jetojmë këtu. I keni zgjedhur këta njerëz dhe nëse bëhet fjalë për probleme ndërmjet presidentit e opozitës, apo presidentit dhe Parlamentit ata duhet ta zgjidhin. Mos na pyesni ne", theksoi euro-parlamentarja. Ajo i kërkon një tryezë të përbashkët opozitës dhe opozitës për problemin e Prokurorisë së Përgjithshme, duke mos përjashtuar as vetë Sollakun. "E dini më mirë se unë se heqja nuk është kaq e thjeshtë. Ka pasur një votim në Parlament të hedhur poshtë nga Gjykata Kushtetuese. Jemi në një situatë me një president të ri e ndërkohë kryeministri Berisha tha se nuk është më në dorën e tij, por në dorën e presidentit dhe Parlamentit të gjeje një zgjidhje. Folëm madje dhe me liderin e opozitës dhe në fund thashë se mund të mbledhim të gjithë aktorët në një tavolinë. Nëse populli ose kryeministri mendojnë se prokurori nuk punon si duhet, atëherë duhet të gjejmë një mënyrë që ta kontrollojmë. Duhet të bëjmë një diagnozë mbi sistemin, së bashku me prokurorin e Përgjithshëm, jo pa të; me të në tryezë e me të tjerë, të kontrollojmë çfarë po ndodh. Nëse nuk punon si duhet apo është keqpërdorur mund të diagnostikohen e nëse ka një rezultat atëherë ka një zgjidhje për këtë problem", theksoi Pack në intervistën dhënë në TV ALSAT. Euro-parlamentarja në emisionin "Studio e Hapur" u shpreh se "Nuk mendoj se ndryshimi i një pozicioni ndryshon gjithë çështjen". "Nëse problemi është prokurori mendoj se do të zbulohet në rast kontrolli, nëse janë procedurat në këtë zyrë mund të zbulohen dhe atëherë duhen parë mënyrat e zgjidhjes dhe atëherë duhen parë mënyrat e zgjidhjes, por duhen marrë në konsideratë se bashku dhe nëse ka nevojë, të gjitha palët janë aty mund ta kontrollojnë e të gjejnë zgjidhjen. S'mund t'ia hedhësh fajin një personi të vetëm që drejton këtë zyrë, pasi nëse ja hedh duhet ta provosh. Por nuk mund të provosh asgjë pa kontrolluar të gjithë situatën. Nëse i mbledh të gjithë së bashku me prokurorin mendoj se mund të ketë një zgjidhje. Por dua të them se nevojitet që kjo çështje të trajtohet me më shumë qetësi", deklaroi Pack. Ndërsa reporteri i Parlamentit Evropian për Shqipërinë, Libor Roucek për "Sollakun" thekson se "kjo është një çështje me shumë rëndësi". "Duhet të kemi Prokurori, gjykata e gjykatës të pavarur. Kështu që p.sh, gjykatësit të mos kenë frikë të gjykojnë në bazë të faktëve e bindjeve të tyre pa u ndikuar nga kjo apo ajo parti. Mendoj se lidhjen me këto çështje e diskutuam dhe më parë me besimin e paanshmërinë në interes të të dajja palëve që këto parime të tilla si qytetësi i pavarur të ngrihen", theksoi Roucek.

BB jep 900 mijë \$ paradhënie për rrugët rurale

Qeveria miratoi dje në parim marrëveshjen me Bankën Botërore, ku kjo e fundit do të japë 900 mijë dollarë paradhënie për kryerjen e të gjitha studimeve për rrugët rurale që do të shtrohen. Sipas relacionit që i bashkëngjitet këtij vendimi, vendi ynë zotëron një inventar rrugës rurale prej 12 mijë km, nga të cilat 4.980 km janë rrugë rurale me karakter komunal dhe 4.471 km janë rrugë me karakter rajonal. Kjo shumë do të përdoret për shërbime konsultive për ndërmarrjen e studimit të fizibilitetit për prioritetin e seksioneve të rrugëve sekondare dhe lokale në rrjetin rrugor; krijimin e një sistemi të përshtatshëm për menaxhimin e aseteve të rrugëve për përcaktimin e investimeve prioritare për rrugët sekondare dhe lokale; përgatitjen së bashku me përfaqësuesit e komunitetit lokal projektet inxhinierike të detajuara dhe dokumentet e tenderit për një program investimesh 5-vjeçar. Duke u ndalur te kjo marrëveshje, Kryeministri theksoi se fatmirësisht ky projekt do të aktivizohet pothuajse menjëherë. Është vendosur që si agjenci e zbatimit të këtij projekti të jetë Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Banka Botërore ka qenë shumë e kënaqur në përzgjedhjen e kësaj agjencie, ndërkohë që politikbërës ose vendimmarrës për këto çështje do të jenë qarqet. Në mënyrë të preferueshme këto do të jenë rrugë qarku, por do fillohet më parë me rrugët në zonat bujqësore".



LLOTARIA E RE AMERIKANE

Fatit i hedhjes së Llotarisë:

3 TETOR – 2 DHJETOR 2007

Avokatë me eksperiencë shumë vjeçare në Llotarinë Amerikane, ju ftojnë të aplikoni

VETEM NEPERMJET INTERNETIT

Fati po troket ne deren tuaj. Provojeni !

Tel: 04240800; Cel: 0684060840
Email: kapitaldam@albmail.com

PRISNI KUPONIN DHE DO TË PËRFITONI 200 LEKË ULJE.